

Takimi i 1514-të, 3-5 dhjetor 2024 (DH)

Të Drejtat e Njeriut

H46-1 Grupi Luli dhe të Tjerët kundër Shqipërisë (Kërkesa Nr. 64480/09)

Monitorimi i ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane

Dokumentet e referencës

[CM/Notes/1514/H46-1](#)

Vendime

Të deleguarit

1. rikujtuan se çështjet e ekzaminuara kanë të bëjnë me zgjatjen e tepërt të procedurave gjyqësore në çështjet civile dhe penale dhe mungesën e mjeteve efektive të brendshme juridike në këtë drejtim;

Për sa i përket masave individuale

2. shënuan se nuk nevojiten masa të mëtejshme individuale në *Gjonboçari dhe të tjerët, Lacey e të tjerë, Mulla, Zeqo dhe Seat Sh.PK, Hamitaj, Vicktoria Sh.P.K dhe Vjola Sh.P. K. dhe De Sh.P. K.* çështje të miratuara me Rezolutën Përfundimtare CM/ResDH(2024)329;

3. ftuan autoritetet të japin informacion mbi pagesën e shpërblimit të drejtë në rastin e fundit *Iliria SRL* dhe mbi gjendjen e procedimeve në lidhje me ankimin Kola nga çështja *Bara dhe Kola*, çështjet *Kokalari* dhe *Luli e të Tjerët* dhe, sipas rastit, të marrë masa për të përshpejtuar çdo gjykim në pritje;

Për sa i përket masave të përgjithshme

4. mirëpritën informacionin që tregon se gjykimet para Gjykatës Kushtetuese duket se janë përfunduar brenda një kohe të arsyeshme dhe se numri i konsiderueshëm i çështjeve të prapambetura në Gjykatën e Lartë ka filluar të zvogëlohet; megjithatë vunë në dukje me shqetësim rritjen e numrit të çështjeve të prapambetura dhe kohëzgjatjen mesatare të lartë të gjykimeve në shumicën e gjykatave të shkallës së dytë dhe sfidat që ende ndikojnë në punën e disa prej gjykatave të shkallës së parë, lidhur me përqindjen e lartë të vendeve vakante për gjyqtarë dhe personel tjetër;

5. përshëndetën, në këtë kuadër, përfundimin e afërt të vetingut në shkallën e parë; u bënë thirrje autoriteteve të sigurojnë përfundimin e gjykimeve të apelit në çështjet e vetingut përpara afatit kushtetues të qershorit 2026;

6. përshëndetën më tej që Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë funksionojnë në përbërje të plotë dhe vunë në dukje me interes progresin e bërë në plotësimin e vendeve vakante të gjyqtarëve; ftuan autoritetet të përdorin të gjitha mjetet për të përshpejtuar emërimet gjyqësore, duke përfshirë fondet shtesë buxhetore dhe për të sqaruar nëse hapa shtesë janë të nevojshëm për të siguruar pranime të mjaftueshme në Shkollën Kombëtare të Magjistraturës, ose ndonjë masë kalimtare; gjithashtu i ftuan ato të sigurojnë

shpërndarjen e duhur të emërimeve të gjyqtarëve, ngarkesën e punës dhe mbështetjen nga stafi i administratës gjyqësore për gjykatat më të mbingarkuara;

7. vunë në dukje gjithashtu me interes masat e rëndësishme dhe komplekse të zbatuara (si reforma e hartës gjyqësore) ose në proces (si p.sh. strategjia për uljen e çështjeve të prapambetura dhe punën në sistemet e menaxhimit të çështjeve), të cilat mund të përmirësojnë efikasitetin e gjykatave në pritje të plotësimit të stafit të tyre me gjyqtarë;

8. mirëpritën dhe inkurajuan angazhimin e autoriteteve në aktivitetet e bashkëpunimit, veçanërisht projektin e përbashkët të Bashkimit Evropian/Këshillit të Evropës “Forcimi i Cilësisë dhe Efikasitetit të Drejtësisë në Shqipëri” (SEJ IV);

9 . ftuan autoritetet të paraqesin informacion për të gjitha aspektet e mësipërme deri më 31 gusht 2025, duke përfshirë informacionin përkatës statistikor dhe informacionin e detajuar mbi funksionimin e mjeteve juridike të brendshme, duke marrë parasysh pyetjet dhe aspektet e identifikuara në analizën e Sekretariatit.